

Akt Themelimi **i shoqërisë tregtare** **“FORB AUTO RENTAL” SHPK**

Sot më datë 21 Maj 2024, në Tiranë, ndërmjet themeluesve të legjitimuar:

- 1. OLTION SAMARXHI**, shtetas Shqiptar me numër personal H60609047W, i biri i Rolandit dhe Afërditës, i lindur në Kukës, më 09 Qershor 1976, banues në rrugën “Don Bosko”, kompleksi ICE, Hyrja 3, apartamenti 24, Njësia Administrative nr. 11, 1026 Tiranë, me identitet të konfirmuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 0384764365 të lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 17 Gusht 2022 dhe të vlefshëm deri më 16 Gusht 2032 (fotokopja bashkangjitur këtij akti);
- 2. Z. BLEDAR ARAPI**, shtetas Shqiptar me numër personal H91024053N, i biri i Feritit dhe i Hanmes, i lindur në Ngurrez, Lushnje, më 24 Tetor 1979, banues në rruga “Thoma Koxhaj”, pallatet “Çabej”, Hyrja D, Apartamenti 4, Njësia Administrative 6, Tiranë, me identitet të konfirmuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 036388091 të lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 03 Shtator 2020 dhe të vlefshëm deri më 02 Shtator 2030 (fotokopja bashkangjitur këtij akti).

Neni 1 - Parakushte


Palët nënshkruese të këtij akti, në mbështetje të neneve 68 e vijues në ligjin nr. 9901 dt. 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në ligjin nr. 131/2015 dt. 26 Nëntor 2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", në nenet 24 e vijues të Kodit Civil si ortakë kanë vendosur të zhvillojnë veprimtari tregtare private dhe për këtë arsye shprehin në këtë dokument vullnetin për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas përcaktimeve të mëposhtme:

Siglimet e Themeluesve

Oltion Samarxhi



Bledar Arapi



Neni 2 - Organizimi

¹ Në marrëveshje ndërmjet nënshkruesve, themelohet një person juridik në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin tregtar “FORB AUTO RENTAL” SHPK.

² Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- a.** Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim-marrës.
- b.** Administratori, për drejtimin e politikave financiare të shoqërisë dhe marrëdhëniet me të tretët.

Neni 3 - Objekti

“FORB AUTO RENTAL” SHPK ka për objekt të aktivitetit të saj tregtar:

- Administrimin dhe dhënien me qera afatshkurtër të aseteve të saj, ose të të tretëve kryesisht automjete, por dhe mjete e sende të tjera për të cilat shoqëria ka marrë ligjërisht të drejtat e përdorimit me të drejtë nënqeradhënie;
- Ndërmjetësimin për dhënien e aseteve me qera ndërmjet subjekteve të sa drejtës;

Neni 4 - Selia

Selia ligjore dhe administrative e “FORB AUTO RENTAL” SHPK do të jetë në adresën rruga “Thoma Koxhaj”, Pallatet “Çabej”, hyrja D, apartamenti 4, Njësia Administrative 6, Tiranë.

Neni 5 – Kapitali, Kuotat dhe Kontributet


¹ Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga vlera prej 10’000 (dhjetë mijë) Lekë të kontribuara nga ortakët themelues për llogari të shoqërisë.

² Kuotat e kapitalit themeltar në marrëveshje mes tyre zotërohen nga ortakët themelues si më poshtë:

- a.** Ortaku themelues **OLTION SAMARXHI** zotëron kuotën prej 70 % (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 7’000 (shtatë mijë) Lekë.

Siglimet e Themeluesve

Oltion Samarxhi



Bledar Arapi



- b.** Ortaku **BLEDAR ARAPI** zotëron kuotën që përbën 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 3'000 (tre mijë) Lekë.

Neni 6 – Kohëzgjatja e aktivitetit

¹ Shoqëria “FORB AUTO RENTAL” SHPK do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar e të pakufizuar nga afate kohore, që fillon ditën e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar dhe mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së ortakëve konform përcaktimeve ligjore.

² Aktiviteti i zakonshëm do të zhvillohet i ndarë në vite financiare, që në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit posaçëm tatimore do të zhvillohen ndërmjet 1 Janarit të çdo viti dhe ditës së fundit të Dhjetorit të po atij viti. Viti i parë financiar i shoqërisë do të quhet i filluar në ditën e regjistrimit të saj në regjistrat e shoqërive tregtare.

Neni 8 – Asambleja

Asambleja e ortakëve të shoqërisë përbëhet nga të gjithë ortakët zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të saj dhe ka kompetenca të plota për vendimmarrjen rregulluese të të gjithë akteve të nevojshme për organizimin e funksionimin e shoqërisë dhe fushave të veprimtarisë së drejtimit dhe përcaktimit të politikave për ushtrimin e aktivitetit tregtar, në kufijtë e përcaktimeve staturore dhe atyre të legjislacionit shqiptar në fuqi.


Neni 7 – Administratori

¹ Aktiviteti i zakonshëm i shoqërisë do të drejtohet nga Administratori i saj, i cili e përfaqëson këtë në marrëdhëniet me të tretët, gëzon të drejtat dhe mban detyrimet e përgjegjësitë e parashikuara në statutin e shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë, në kufijtë e përcaktimeve të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

² Për mandatin e parë 5 (pesë) vjeçar të administrimit të shoqërisë së sapoformuar themeluesit vendosin që shoqëria të ketë Administrator, Ortakun

Siglimet e Themeluesve

Oltion Samarxhi



Bledar Arapi



BLEDAR ARAPI, shtetas Shqiptar, me të dhëna identifikuese të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij akti.

Neni 8 – Elemente konstitutive

¹ Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të saj, e cila me regjistrimin e saj i merr përsipër këto shpenzime si detyrime.

² Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me dispozitat e këtij akti themelimi dhe në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, e do të funksionojë në zbatim të përcaktimeve të statutit të miratuar nga Asambleja themeluese, akt që për efekte regjistrimi i bashkangjitet këtij akti themelimi.

Neni 9 – Dispozitë përfundimtare


¹ Ky akt themelimi është hartuar në gjuhën shqipe, në 4 (katër) fletë të shkruara në kompjuter, pa asnjë korrigjim në 5 (pesë) kopje, me vlerë të njëjtë ligjore, në bazë të vullnetit të ortakëve themelues në mbledhjen e tyre të parë themeluese.

² Për interpretimin dhe zbatimin e përcaktimeve të këtij akti palët dhe personat e legjitimuar do të mbështeten në legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe zakonet e mira të fushës tregëtare.


³ Pas pranimit të disponimeve dhe vullnetit sipas përmbajtjes së mësipërme ortakët themelues nënshkruajnë aktin e themelimit dhe i bashkangjisin atij statutin duke ju dhënë këtyre akteve fuqi ligjore që nga data e nënshkrimit.

Ortakët themelues

OLTION SAMARXHI

Oltion Samarxhi


BLEDAR ARAPI

Bledar Arapi


Siglimet e Themeluesve

Oltion Samarxhi

Bledar Arapi

4

Bledar Arapi